



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

16.04.2018

NJOFTIM

Të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, ju njoftojmë se Draft Rregullorja për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë-OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (shqyrtimi i parë), gjendet në fazën e diskutimit publik, prandaj mirëpresim sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e juaja deri më 07.05.2018, kur edhe përfundon periudha e diskutimit publik të kësaj Rregulloreje.

Të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e juaja mund të i dërgoni në emaillet: fatmire.cecelia@rks-gov.net dhe sylejman.meholli@rks-gov.net

Të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet do t'i bashkëngjiten Draft Rregullores në fjalë për tu diskutuar dhe aprovuar në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal në Vushtri.

Me Respekt:

Sylejman Meholli

Drejtor i DSHPS

Me Respekt:

Fatmire Cecelia

Drejtor i DKRS



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Datë: 01 mars 2018

Për: KPF dhe Kuvendin e Komunës

Propozues: Xhafer Tahiri, Kryetari i Komunës _____

Hartues: Komisioni në këtë përbërje:

- 1. Alban Tahiraj, nga Zyra Ligjore _____,**
- 2. Naim Ferizi, nga DSHPS-ja _____,**
- 3. Shukrane Begu, nga DKRS-ja _____.**

Lënda: Draft-Rregullore për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (shqyrtimi i parë)



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës -Vushtri

R R E G U L L O R E (KKV) Nr. ____/2018

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE
FINANCIARE NGA
FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE JURIDIKË –
OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE FIZIKË**

Vushtri, mars 2018



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) lidhur me nenin 17, pikat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 41, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2018, miraton këtë:

RR E G U L L O R E
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE
FINANCIARE NGA
FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE JURIDIKË -
OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE FIZIKË

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për persona juridikë - OJQ dhe ndihmë momentale për persona fizikë.
2. Kjo rregullore nuk vlen për kategori të tjera të personave juridikë, përveç atyre që kanë statusin e organizatave jo qeveritare me karakter jo përfitues.
3. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual komuna, ndan mjete financiare buxhetore – ndihmë momentale për persona juridikë - OJQ dhe fizikë, në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje, këto përkufizime kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Subvencionet** – janë të gjitha transferet financiare të njëanshme, të pakthyeshme në llogari rrjedhëse të përfituesit (personave juridikë-OJQ dhe personave fizikë), për të cilat komuna nuk pranon kundërvlerë.
 - 1.2. **Persona juridikë** - janë vetëm organizatat jo qeveritare të karakterit jo përfitues.
 - 1.3. **Përfitues** – janë personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë dhe në pajtim me Ligjin për Buxhetin.

1.4. Banor rezident – nënkupton personin që jeton dhe vepron prej pesë (5) viteve në Komunën e Vushtrrisë, si dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

1.5. LMFPP – Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 3 Limitet buxhetore

Komuna e Vushtrrisë ndanë subvencione, duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin për vitin fiskal, për të cilin ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4 Rregullat e përgjithshme për parashtrimin e kërkesës për subvencion

1. Komuna e Vushtrrisë ndanë subvencione në shumën mbi pesëqind (500) € përmes thirrjes publike për aplikim për persona juridikë – OJQ, dhe mbi bazën e kërkesave për personat fizikë, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Kryetari i komunës aprovon ndarjen e subvencioneve në këto limite:

2.1. Për persona juridikë – OJQ deri në pesëqind (500) €.

2.2. Për persona fizikë për ndihmë momentale për shërim mbi treqind (300) € deri në një mijë (1.000) €.

Neni 5 Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna e Vushtrrisë zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës momentale në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Në thirrjen publike për ndarje të subvencioneve, përcaktohen qartë fushat e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas kriterëve të parapara në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

3. Në rastin e inicimit të procedurës për ndarjen e subvencioneve, organi duhet të sigurohet nga Zyrtari kryesor financiar, për disponueshmërinë e mjeteve financiare për realizimin e projektit ose ekzekutimin e vendimit, në të kundërtën konform nenit 37, paragrafi 1 të LMFPP-së, organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që tejkalon fondet e ndara.

Neni 6

Subvencionimi i personave juridikë - OJQ

1. Subvencionimi për persona juridikë – OJQ nga ana e Komunës së Vushtrrisë bëhet duke u bazuar në parimet si në vijim:

- 1.1. Konkurrenca;
- 1.2. Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i aplikuesve, si dhe gjithëpërfshirja gjinore e përfituesve;
- 1.3. Transparenca në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin dhe përzgjedhjen e përfituesve;
- 1.4. Kriete të caktuara më parë, të cilat mundësojnë vlerësimin e propozimeve dhe aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioriteteve të mbështetjes financiare;
- 1.5. Parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;
- 1.6. Respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike;
- 1.7. Financimi përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë në interes të publikut.
- 1.8. Ruajtjen e pavarësisë së përfituesve;
- 1.9. Parandalimin e çfarëdo konflikti të interesit;
- 1.10. Sigurimin e dyshkallshmërisë (të drejtën e ankimit) në trajtimin e ankesave të aplikuesve, dhe
- 1.11. Parandalimin e financimit të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.

Neni 7

Planifikimi i mbështetjes financiare

1. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofruer i mbështetjes financiare planifikon mbështetje financiare në kuadër të buxhetit vjetor.
2. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofruer i mbështetjes financiare përgatit pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë – OJQ-të më së largu tridhjetë (30) ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.
3. Plani vjetor i mbështetjes financiare për personat juridikë – OJQ-të përmban:

- 3.1. Informatën për organizatën buxhetore;
 - 3.2. Shumën e mbështetjes buxhetore për vitin fiskal;
 - 3.3. Fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për personat juridikë – OJQ-të;
 - 3.4. Objektivat e mbështetjes financiare;
 - 3.5. Numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë;
 - 3.6. Kohën e hapjes të thirrjes për aplikim, dhe
 - 3.7. Kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.
4. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare duhet të publikojë në uebfaqen e vetë zyrtare, pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë - OJQ-të, më së largu pas dyzet e pesë (45) ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.
 5. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin Vlerësues, i cili do të merret me vlerësimin e aplikimeve sipas thirrjes publike dhe të bëjë përzgjedhjen e përfituesve.
 6. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin e ankesave, i cili do të merret me trajtimin e ankesave eventuale të aplikantëve.
 7. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me persona juridikë – OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.
 8. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të sigurojë përkrahjen e nevojshme për Komisionin vlerësues, Komisionin e ankesave dhe zyrtarin apo ekipin për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke siguruar burimet e nevojshme financiare dhe administrative për zbatimin e suksesshëm të thirrjes publike dhe për monitorimin dhe vlerësimin e mbështetjes financiare.

Neni 8

Komisionet vlerësuese

1. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare në vlerë mbi pesëqind (500) €, themelon Komisionin

vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.

2. DKRS-ja formon Komisionin vlerësues për subvencionimin e personave juridikë – OJQ-të në vlerë deri në pesëqind (500) €, si dhe personave fizikë për realizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në gjashtëqind (600) €. Ky komision ka mandat dy (2) vjeçar, në përbërje prej tre (3) anëtarëve.
3. DSHPS-ja formon Komisionin vlerësues për subvencionimin e personave fizikë për ndihmë momentale për shërim dhe për furnizim me gjëra ushqimore. Ky komision ka mandat dy (2) vjeçar, në përbërje prej tre (3) anëtarëve.
4. Përbërja e komisionit (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës.
5. Komisioni vlerësues (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), përbëhet nga pesë (5) anëtarë, dhe ka mandat dy (2) vjeçar, si në vijim:
 - 5.1. një (1) përfaqësues nga njësia përkatëse (drejtoria përgjegjëse), në kuadër të të cilit është planifikuar mbështetja financiare;
 - 5.2. dy (2) përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrjeje publike, të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare;
 - 5.3. dy (2) përfaqësues nga institucioni (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) që ofron mbështetje financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa.
6. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit vlerësues nga paragrafi 5 i këtij neni, Komuna e Vushtrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit vlerësues, i cili ka konflikt të interesit.
7. Komisioni vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të komisionit.
8. Komisioni vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
9. Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
10. Me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës do të përcaktohet mënyra dhe shuma e kompensimit për dy (2) anëtarë e Komisionit vlerësues të përmendur në nënparagrafin 5.2 të këtij neni.

11. Kërkesat për ndarjen e subvencioneve nga paragrafët 2 dhe 3, paraprakisht i shqyrton Komisioni vlerësues i DSHPS-së, gjegjësisht DKRS-së, të cilët ia rekomandojnë Kryetarit të Komunës rastet e përzgjedhura për përfitim financiar.
12. Përbërjen e Komisionin vlerësues të DSHPS-së dhe DKRS-së si në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, drejtorët e drejtorive përkatëse ia propozojnë për aprovim Kryetarit të Komunës.
13. Drejtori i DSHPS-së propozon mjete financiare për shërim në vlerë deri në treqind (300) €, kurse për gjëra ushqimore deri në dyqind (200) € pas shqyrtimit të kërkesave dhe rekomandimit nga Komisioni vlerësues i DSHPS-së.
14. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300) € deri në një mijë (1.000) €, pas shqyrtimit, Komisioni vlerësues i DSHPS-së i rekomandon për aprovim Kryetarit të Komunës, konform kritereve të plotësuara të kësaj rregulloreje.
15. Drejtori/esha i/e DKRS-së propozon mjete financiare për aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në treqind (300) € pas shqyrtimit të kërkesave dhe rekomandimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së.
16. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300) € deri në gjashtëqind (600) € për personat fizikë (të jashtëm), pas shqyrtimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së i rekomandohen për aprovim Kryetarit të Komunës, konform kritereve të plotësuara të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Komisioni i Ankesave

1. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare, themelon komisionin e ankesave, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave të aplikantëve.
2. Komisioni i ankesave ka mandat të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kritereve procedurale të parapara me këtë rregullore, si dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.
3. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe ka mandat dy (2) vjeçar.
4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të ankesave nga paragrafi 3 i këtij neni, Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevoje anëtarin e Komisionit të ankesave, i cili ka konflikt të interesit.
5. Përbërja e komisionit caktohet me Vendim të Kryetarit të Komunës. Në Komisionin e ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët, të cilët janë pjesë e Komisionit vlerësues dhe të emëruarit politikë.

Neni 10
Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë aplikuesit dhe parashtruesit e kërkesave

1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit (në cilësinë e personave juridikë - OJQ) mbi pesëqind (500) €, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
 - 1.1. të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatën joqeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
 - 1.2. të jenë të pajisura me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionit ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
 - 1.3. të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
 - 1.4. të mos kenë pranuar mjete tjera nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
 - 1.5. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Parashtruesit e kërkesave në cilësinë e personave juridikë deri në pesëqind (500) € duhet t'i plotësojnë kriteret e përmendura në nënparagrafët e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 11
Dokumentacioni për parashtrimin e kërkesave për persona fizikë

1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, parashtruesit e kërkesave (në cilësinë e personave fizikë) deri në treqind (300) € duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
 - 1.1. Kërkesa, e cila duhet të parashtrohet në emër të personit me sëmundje;
 - 1.2. Raportet mjekësore specialistike që konstatojnë sëmundje të rëndë;
 - 1.3. Raporti për gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale;
 - 1.4. Dëshmi për gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale, të verifikuar nga komisioni i DSHPS-së (kartoni i socialit), dhe

- 1.5. Dëshmi e shpenzimeve mjekësore apo shpenzimeve të terapisë.

Neni 12 **Kushtet specifike**

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet t'i plotëson kushtet specifike konform nenit 11 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 13 **Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike dhe aplikimit**

Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike dhe aplikimit, si dhe udhëzimeve dhe mënyrës së aplikimit për aplikantët, kritereve dhe procedurave të vlerësimit të aplikacioneve duhet të zbatohen konform neneve 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 14 **Parandalimi i konfliktit të interesit**

Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të sigurojë shmangien e çfarëdo konflikti të interesit në rastin e marrjes së vendimit për aplikuesit (parashtruesve të kërkesave).

Neni 15 **Afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave**

1. Kundër vendimit të Komisionit vlerësues, aplikantët mund të ushtrojnë ankesë në Komisionin e ankesave, si në vijim:
 - 1.1. ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mospërmbushjes së kritereve formale gjatë vlerësimit të aplikacionit në aspektin procedural, dhe
 - 1.2. ankesë ndaj vendimit për ofrimin apo mos ofrimin e mbështetjes financiare.
3. Ankesat i drejtohen Komisionit të ankesave dhe duhet të dorëzohen brenda pesë (5) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.
4. Komisioni i ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.
5. Komisioni i ankesave mund të nxjerr vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.
6. Vendimi i Komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative.
7. Vendimi duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit vlerësues.

8. Komisioni i ankesave mban procesverbal për gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.

Neni 16

Kontrata me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit

Mënyra e hartimit të kontratës me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit duhet të bëhen konform neneve 22 dhe 23 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 17

Rastet e përfitimit të subvencioneve, duke mos iu nënshtruar thirrjes publike

1. Rastet që përfitojnë subvencione, duke mos iu nënshtruar thirrjes publike janë:
 - 1.1. Personat juridikë – OJQ, deri në pesëqind (500) €.
 - 1.2. Personat fizikë për ndihmë momentale për shërim, deri në një mijë (1000) €.
 - 1.3. Personat e jashtëm fizikë, derë në gjashtëqind (600) €.
 - 1.4. Personat fizikë për ndihmë momentale për furnizim me gjëra ushqimore, deri në dyqind (200) €.

Neni 18

Dokumentacioni i nevojshëm për subvencionimin e personave juridikë - OJQ

1. Personat juridikë - OJQ për të parashtruar kërkesë për subvencionim, duhet ta dorëzojnë këtë dokumentacion:
 - 1.1. kërkesën me shkrim;
 - 1.2. dorëzimin e raportit për vitin paraprak, në rast të subvencionimit të mëhershëm;
 - 1.3. certifikatën e regjistrimit;
 - 1.4. arsyetimin e kërkesës;
 - 1.5. dokumentin identifikues të përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
 - 1.6. numrin e llogarisë bankare të personit juridik.

Neni 19

Bashkëfinancimet

1. Komuna mund të lidhë marrëveshje të mirëkuptimit me institucione qendrore, organizata dhe mekanizma tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë (donatorë), përfshirë edhe persona fizikë për realizim të projekteve me interes publik për qytetarë (familje dhe individ) të Komunës së Vushtrrisë, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike, si në vijim:

- 1.1. Kryetari i komunës vendos lidhur me marrëveshjet për bashkëfinancim për projektet në të cilat komuna merr pjesë deri në 49 % të vlerës së përgjithshme të projektit.
- 1.2. Kuvendi i komunës vendos lidhur me bashkëfinancimin për projektet në të cilat komuna merr pjesë 50 % e më tepër të vlerës së përgjithshme të projektit.

2. Kushtet dhe kriteret për përcaktimin e përfituesve të projekteve të tilla do të caktohen në marrëveshjen në mes të donatorit dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 20

Subvencionimi për pagesën e qirave në raste të rënda sociale (familjeve të pa strehë) dhe përfituesit e të drejtës për pagesën e qirasë

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet në nevojë përmes aprovimit vjetor të buxhetit.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Vushtrrisë që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.
3. Numri i familjeve përfituese nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët, të cilët në Komunën e Vushtrrisë janë rezident së paku prej pesë (5) viteve.
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumë prej njëqind (100) euro, për një (1) muaj.

Neni 21

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për subvencionimin e qirasë të familjeve në nevojë

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat (rastet) e paraqitura janë:

- 1.1. statusi i banimit;

- 1.2. lartësia e të ardhurave;
- 1.3. gjendja shëndetësore;
- 1.4. invaliditeti, dhe
- 1.5. struktura e familjes.

Neni 22

Përparësitë për zgjedhjen e përfituesve

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:
 - 1.1. familjet me shumë fëmijë;
 - 1.2. familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me nevoja të veçanta;
 - 1.3. familjet ku kryefamiljari është grua – mbajtëse e familjes;
 - 1.4. bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar, që nuk ka në përkujdesje fëmijë, dhe
 - 1.5. fëmijët me statusin e jetimit.

Neni 23

Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i komunës, drejtori i DSHPS-së lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individ i që i plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.
2. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite.
3. Kontrata lidhet në afat një (1) vjeçar me mundësi të vazhdimit konform afatit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.
4. DSHPS-ja njofton përfituesin e subvencionit dhe qiradhënësin e qirasë së banimit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të afatit të kontratës së fundit (për herën e pestë) se komuna nuk do të vazhdojë t'i paguajë qiranë e banimit dhe nuk do të lidhë kontratë të re të banimit.

Neni 24

Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë (shkëputja e kontratës së qirasë)

1. Palës përfituese të subvencionimit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë (shkëputja e kontratës së qirasë) kur:

- 1.1. qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat;
 - 1.2. qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
 - 1.3. qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
 - 1.4. qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore Komisioni Vlerësues i DSHPS-së;
 - 1.5. qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale, dhe
- 1.3. qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës.

Neni 25

Subvencionimi nga fusha e rinisë, kulturës dhe sportit

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndanë subvencione për persona fizikë të jashtëm dhe persona juridikë-OJQ për projekte-ide me karakter: profesional, promovues, stimulues, tradicional, inovativ, kritik, praktik, ku përfshihen:
 - 1.1. Aktivitetet kulturore;
 - 1.2. Aktivitetet rinore, dhe
 - 1.3. Aktivitetet sportive.

Neni 26

Rastet specifike për zgjedhjen e përfituesve

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, iu jepet përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
 - 1.2. projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
 - 1.3. parashtruesve të kërkesave që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 27
Dokumentacioni për parashtrimin e kërkesave

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë parashtrimit të kërkesave për ndarje të subvencioneve janë:

1.1. projekt-propozimi;

1.2. formulari;

1.3. dokumenti identifikues;

1.4. certifikata e vendbanimit (për persona fizikë);

1.5. certifikata e regjistrimit (për persona juridikë);

1.6. dëshmi për pagesën e taksave komunale;

1.7. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

1.8. dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridikë), dhe

1.9. konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e parashtruesit të kërkesës.

Neni 28
Zbatimi dhe mbikëqyrja

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 29
Dispozita shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen: Rregullorja për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhmë Momentale të Entiteteve Publike dhe Jopublike, me nr. 37/11 të datës 24/02/2011.

2. Në rast se ka mospërputhje në mes të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vlejné dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 30 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

A R S Y E T I M

Me kërkesë të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorisë për Kulturë dhe Sport (konform Planit vjetor të punës së kuvendit), Kryetari i komunës ka formuar Komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.37-2/11 për Përcaktimin e Krieteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike.

Komisioni pas përgatitjes së plotësim-ndryshimeve, ka konstatuar se është e nevojshme përfshirja e ndryshimeve dhe përgatitja e tekstit të spastruar për miratim nga Kuvendi i Komunës, duke shtuar edhe elementet e domosdoshme nga Rregullorja MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Komisioni në fjalë në këtë draft-rregullore ka trajtuar edhe rastet e subvencionimit të personave juridikë – OJQ mbi shumën e pesëqind (500) €, të cilët duhet t'i nënshtrohen thirrjes publike për aplikim, si dhe formimin e tri (3) komisioneve vlerësuese: Komisionin vlerësues (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), Komisionin Vlerësues nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komisionin Vlerësues nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Gjithashtu është paraparë edhe

themelimi i Komisionit të ankesave (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare). Në këtë draft-rregullore është trajtuar edhe bashkëfinancimi, si dhe rastet e pagesës së qirasë për banim.

Draft-rregullorja me ndryshimet e bëra, ka pësuar ndryshime përmbajtësore, prandaj të njëjtën e procedojmë për shqyrtim në KPF dhe KK, në mënyrë që të procedohet për dhënie në diskutim publik, dhe pas përfundimit të diskutimit publik të procedohet për aprovim në kuvendin e komunës.